

AKT- THEMELIMI

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“NUOVA VITA” shpk

Në Durrës, sot më datë 24/09/2023, ortakët themelues të shoqërisë

“NUOVA VITA” shpk:

Z. FEDERICO SACCONE, atësia Franco Saccone, i datëlindjes 03/12/1977 , lindur dhe banues në Itali, shtetas Italian, madhor, dhe me zotësi juridike për të vepruar, identifikuar nëpërmjet kartës së identitetit me numër AU5346290.

dhe

Znj. ELISA BIASINI, atësia Giulio Biasini, e datëlindjes 11/09/1982 , lindur dhe banuese në Itali, shtetase Italiane, madhore, dhe me zotësi juridike për të vepruar, identifikuar nëpërmjet kartës së identitetit me numër AZ1559113.

Të cilët me cilësinë e “Ortakëve themelues” kërkuar redaktimin e këtij akti themelimi, nëpërmjet të cilit deklaroi se me vullnet të lirë të plotë e të sinqertë, dhe inisiativën e lirë private, mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Kodin Civil në fuqi, në ligjin 9901 datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, ligjin nr.9723, datë 03.05.2007 “Për Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit”, në atë Doganor, Fiskal e Tatimor, krijon shoqërinë tregtare, me përgjegjësi të kufizuar, **“NUOVA VITA” shpk**

KREU I

Neni 1

Krijimi


“NUOVA VITA” shpk


Është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë e quajtur “Shoqëria”).

Neni 2

Personaliteti juridik

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara në ligj Shoqëria “NUOVA VITA” shpk, është një shoqëri tregtare, e themeluar nga shtetasi Italian **Z. FEDERICO SACCONE**, dhe shtetasja Italiane **Znj. ELISA BIASINI**, të cilët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributi i ortakëve përbën kapitalin e regjistruar të shoqërisë.





Neni 3

Selia

Shoqëria e ka selinë në: Lagja 14, Shkozet, Nd. 292, Nr. Pas. 10/9+5-6, vol.21, fq.63, Zk. 8516, Nr. Ap. 6, Durrës.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj , te hapë zyra përfaqësie, degë, të krijoj filiale, si brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë , vetëm me vendimin e Ortakëve themelues .

Neni 4

Objekti i veprimtarisë

Terapi profesionale, rehabilitimi konjitiv dhe autonomi për personat me aftësi të kufizuara.Rehabilitim për zhvillimin e autonomisë dhe për lehtësimin e përfshirjes sociale të personave me aftësi të kufizuara të të gjitha moshave. Veprime në proceset motorike, shqisore dhe njohëse për ta shtyrë pacientin drejt pavarësisë së plotë në çdo moment të jetës së tij. Ofrimi i mbështetjes që bën ndryshimin në jetën e pacientit, me një sens të ripërtërirë qëllimi duke hapur horizonte të reja, gjetja e zgjidhjeve për problemet e përditme duke marrë parasysh nevojat fizike, psikologjike, sociale dhe mjedisore të pacientëve.

Neni 5

Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

KREU II

Kapitali

Neni 6

Kapitali themeltar

1. Kapitali themeltar I Shoqërisë është në vlerën 100 000 (njëqind mijë) Lekë. Kontributi I Ortakeve përbën kapitalin e regjistruar të Shoqërisë.
2. Pjesëmarrja e Ortakeve në Shoqëri është në raport me kontributet e tyre, dhe vlera nominale e kuotave të tyre, e cila llogaritet në raport me këtë kontribut, është 50 000 Lekë secili, e paraqitur në mënyrë të përmbledhur në tabelën e mëposhtme:

<u>NR.</u>	<u>Emri I Ortakut</u>	<u>Kuota</u>	<u>Vlera</u>	<u>Përqindja</u>
<u>1</u>	<u>FEDERICO SACCONE</u>	<u>1</u>	<u>50 000 Lekë</u>	<u>50</u>
<u>2</u>	<u>ELISA BIASINI</u>	<u>1</u>	<u>50 000 Lekë</u>	<u>50</u>
	<u>TOTALI</u>	<u>2</u>	<u>100 000 Lekë</u>	<u>100</u>

3. Kapitali mund të ndryshojë me vendim të Asamblesë së Ortakeve sipas normave të fushës në fuqi.

4. Kapitali është shlyer tërësisht.

Federico Saccone

Elisa Biasini

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuota e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) Kontributit në kapitalin e shoqërisë
- b) Shitblerjes
- c) Trashëgimisë
- d) Dhurimit
- e) Çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidarë ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri ne çastin e regjistrimit të kalimit të saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarrës

Ortakët e shoqërisë janë organi vendimmarrës i shoqërisë. Ortakët e shoqërisë janë organi vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj. Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë

Ortakët vendosin për çështje si :

- a) Përcaktimi i politikave tregëtare të shoqërisë
- b) Emërimin dhe shkarkimin e administratorëve
- c) Emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar
- d) Përcaktimin e shpërblimeve
- e) Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregëtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- f) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- g) Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Të gjitha vendimet e marra nga ortakët regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për :

- a) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;

felix seane

disa hiesin

- b) Shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) Investime;
- d) Vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i drejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 9

Administrimi

Administrator i shoqërisë "NUOVA VITA" shpk, caktohet **Z. FEDERICO SACCONI**, i cili emërohet për një afat 5 vjeçar me të drejtë ripërtitje.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të Ortakëve themelues të shoqërisë.

Neni 10



Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të :

- a) Kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregëtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregëtare, të vendosura nga asamblja e përgjithshme;
- b) Përfaqësojë shoqërinë tregëtare;
- c) Kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumentave dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) Përgatisë dhe nënshkruaj bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve i paraqësin këto dokumenta përpara asamblesë së përgjithshme për miratim
- e) Krijoi një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë
- f) Kryej regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë siç parashikohet në ligjin për QKR.
- g) Raportoi përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregëtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregëtare.

Administratori është i detyruar të thërrasë në mbledhjen e Asamblesë në rastet kur :

Sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekziston rreziku që aktivet e Shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.



Administratorët, së bashku edhe veças njëri-tjetrit, kanë të drejtë të kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtzakonshëm. Administratorët e përfaqësojnë Shoqërinë përpara të gjithë personave fizik e juridik, publikë dhe/ose privatë vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkallëve. Administratorët kanë të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ja jep shprehimisht ortakëve të shoqërisë.

Administratorët angazhojnë shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj. Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose për të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 11

Viti Financiar

Viti Financiar i shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon në 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në QKR dhe mbyllet në 31 dhjetor.

Neni 12

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj
- b) me vendim të ortakëve themelues
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit
- d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për 2 vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi I veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit"
- e) me vendim të Gjykatës

Në këtë rast Asambleja merr vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar një apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër".

Neni 13

Baza ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë Akt Themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë Akt Themelimi, do të zbatohen dispozitat e ligjiit "Për tregtarët dhe Shoqërit tregtare", Kodit Civil dhe cfarë do ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 14

Dispozita përfundimtare

Ky Akt Themelimi u redaktua në 4 kopje në gjuhën shqipe, me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike.


Elisa Socani

Elisa Socani

Akti i mësipërm pasi miratohet në parim dhe nen për nen nga Ortakët themelues të shoqërisë tregtare Shpk, nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën e tyre origjinale .

ORTAKËT THEMELUES

FEDERICO SACCONI



ELISA BIASINI

